



Kompania Rajonale e Ujësjetës
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

KRU."GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën:	28	02	2018
Niveli org.	Numri	Shifra	Vlera
	543		

Kompania Rajonale e Ujësjetës "Gjakova" SH.A. Gjakovë



STRATEGJIA PËR ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE TË UJIT 2018-2022

Janar, 2018

Emri dokumentit:	Strategjia për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit 2018 – 2022
Numri i Protokollit:	
Versioni:	01
Aprovuar nga:	Bordi i Drejtorëve
Datë:	24.01.2018
Shpërndarë:	<ul style="list-style-type: none">• Kryeshefi Ekzekutiv• Zyrtari i Lartë Financiar• Departamenti Teknik• Sekretari• Menaxheri i Departamentit të Shitjes• Departamentit të Shërbimeve me Konsumatorë

SHKURTESAT

NJPMNP	Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
ARRU	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës
ISP	Indeksi i Standardizuar i Reshjeve
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjes
KRUGJ	Kompania Rajonale e ujit Gjakova
SZH	Strategjia e Zvogëlimit të humbjeve

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	4
2.	GJENDJA EKZISTUESE.....	6
3.	CAQET E PËRCAKTUARA.....	7
4.	REDUKTIMI I HUMBJEVE APARENTE	9
4.1.	<i>Synimet Operative për Reduktimin e Humbjeve Aparente</i>	10
4.2.	<i>Aktivitetet e Planifikuara</i>	10
5.	REDUKTIMI I HUMBJEVE REALE (FIZIKE).....	19
5.1	<i>Synimet Operative për Zvogëlimin e Humbjeve Reale/Fizike</i>	20
5.2	<i>Aktivitetet e Planifikuara</i>	20
	SHTOJCA 1: AKTIVITETET PËR REDUKTIMIN E HUMBJEVE APARENTE - KALENDARI DHE BUXHETI (NE EXCEL).....	27
	SHTOJCA 2: AKTIVITETET PËR REDUKTIMIN E HUMBJEVE REALE - KALENDARI DHE BUXHETI (NE EXCEL).....	27

Ky dokument është përgatitur nga Departamenti Teknik i KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë, dhe do të shpërdahet në Komunitet në zonën e shërbimit me furnizim me ujë nga kompania e jonë dhe Institucionet përgjegjëse që kanë ndikim në realizimin e këtij plani.

Menaxheri i Departamentit Teknik

Shkodran Gaxherri

1. HYRJE

Humbjet e ujit kanë efekt negativ ekologjik, ekonomik dhe social dhe janë pjesë përbërëse e pashmangshme çdo sistemi të ujësjellësit. Shkalla e ujit të humbur është një indikator i mirë i joefiçencës së sistemit dhe në korrelacion me indikatorët tjerë siç janë efienca financiare dhe efienca operative. Reduktimi dhe kontrollimi i qëndrueshëm i UPF në një sistem të ujësjellësit është një problem kompleks i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Kjo për faktin se humbjet e ujit kanë tendencë natyrale të ngritjes nëse nuk ndërmerren masa adekuate për ndaljen/zvogëlimin e tyre: rrjedhjet nga gypat shtohen vazhdimisht, numri i ujëmatësve që nuk matin saktë rritet, të dhënat për konsumatorët vjetrohen etj.

Ky dokument ka për qëllim që të përkufizojë qasjen e KRU "Gjakova" Sh.A. (KRUGJ) si dhe aktivitetet të cilat do ti ndërmerr në periudhën 2018-2022 për **reduktimin e ujit të pa-faturuar (UPF)** me qëllim të përmbushjes së synimit të saj strategjik, që është: *'Ofrimi i shërbimeve kualitative për të gjithë konsumatorët dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare'*. Këto aktivitete janë të mbështetura në analizimin e sasisë së ujit të humbur si dhe të faktorëve që ndikojnë në humbjet e ujit.

Në rastin e KRUGJ, reduktimi i humbjeve të ujit (UPF) paraqet padyshim një prej sfidave më të mëdha për faktin se aktualisht më tepër se gjysma e ujit të trajtuar të cilin KRUGJ e distribuon në system (7.2milion m³) nuk faturohet si pasojë qoftë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, vjedhjet etj.). Shkalla kaq e lartë e humbjeve të ujit jo vetëm që shkakton humbje substanciale financiare për Kompaninë por ndikon drejtpërdrejt në cilësinë furnizimit të konsumatorëve (ndërprerjet e rregullta në furnizim) që ka për pasojë rrezikimin e cilësisë së ujit dhe rrjedhimisht paraqet kërcënim permanent për shëndetin e popullatës.

Është e qartë se KRUGJ nuk mund ti eliminojë në tërësi humbjet e ujit, megjithatë, Kompania mundet dhe është e vendosur që ti reduktojë substancialisht ato. Rëndësia ekonomike e humbjeve të ujit dhe nevoja për një strategji të reduktimit të UPF mund të ilustruhet me faktin se *reduktimi i UPF në shkallën prej 39.97%* - që është synim i KRUGJ për periudhën deri në vitin 2022 - do të kursente sasi vjetore prej rreth 1.050.000 m³ ujë (7% të zvogëlimin të humbjeve). Kjo sasi e ujit e përkthyer në para, ka vlerën prej 525,000.00 EUR, bazuar në kostot e KRUGJ, respektivisht 810,000.00 EUR, bazuar në tarifën e shitjes të cilat i humb KRUGJ, për çdo vit (sikur të arkëtonte 100% faturat e konsumatorëve), para këto që do të mund të investoheshin në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Për më tepër, me reduktimin e planifikuar të humbjeve të ujit do të përmirësohej cilësia e shërbimeve që iu ofrohen konsumatorëve dhe do të promovohet drejtësia në mes të konsumatorëve duke ndërmarrë veprime ndaj konsumatorëve të kyçur ilegalisht dhe atyre që abuzojnë me shërbimet e ujësjellësit.

Me qëllim të eliminimit të konfuzionit eventual lidhur me terminologjinë e cila përdoret kur bëhet fjalë për humbjet e ujit (përdorimi jokonsistent i termave si: humbjet teknike, humbjet fizike, humbjet administrative, humbjet komerciale etj.), në këtë dokument është përdorur terminologjia standarde e adaptuar në metodologjinë për llogaritjen e bilancit uJOR të Asociacionit Botëror të Ujërave (IWA), ku humbjet e ujit ndahen në:

- Humbjet aparente (komerciale), dhe
- Humbjet reale (fizike).

Tabela standarde e IWA-s, për bilancin uJOR është paraqitur në figurën 1 në vijim:

Tabela 1: Tabela Standarde e IWA-s për Bilancin UJOR

Sasia e Ujit që Hyn në Sistem	Konsumi i Autorizuar	Konsumi i Autorizuar që është Faturuar	Uji i Faturuar i Matur	Uji i Faturuar
			Uji i Faturuar i Pamatur	
	Humbjet e Ujit	Konsumi i Autorizuar që nuk është Faturuar	Uji i Pa-faturuar i Matur	Uji i Pa-faturuar (UPF)
			Uji i Pa-faturuar i Pamatur	
	Humbjet Reale	Humbjet Aparente	Konsumi i Paautorizuar	
			Pasaktësitë e Ujëmatësve	
			Rrjedhjet nga Rrjeti i Transmisionit dhe Distribucionit	
			Rrjedhjet nga Rezervuarët	
		Rrjedhjet nga Kycjet deri te pika e Ujëmatësit		

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, dallimi në mes të konceptit *Humbjet e Ujit dhe Uji i Pa-faturuar (UPF)* konsiston në atë se UPF përfshinë përpos *Humbjeve të Ujit* edhe ujin e konsumuar që është autorizuar por që nuk është faturuar.

Me *Strategjinë për Zvogëlimin e Humbjeve të Ujit 2018-2022*, janë përcaktuar synimet operative për adresimin efektiv të humbjeve të ujit dhe gjithashtu edhe treguesit e matshëm dhe afatet kohore për implementimin e secilës prej masave të planifikuara për reduktimin e UPF.

Strategjia do të rishikohet në baza vjetore. Njëkohësisht, me qëllim të sigurimit të një qasjeje të integruar në zbatimin e kësaj strategjie, **KRUGJ, do ta emërojë një Koordinator për Humbje të Ujit** që do të jetë përgjegjës për koordinimin adekuat të aktiviteteve të planifikuara. Koordinator i UPF do të raportojë në baza të rregullta (muajore) tek Menaxhmenti i Kompanisë për progresin në arritjen e synimeve të përcaktuara.

2. GJENDJA EKZISTUESE

Parakusht për hartimin dhe implementimin e një strategjie të zvogëlimit të humbjeve të ujit është diagnostifikimi i gjendjes ekzistuese në bazë të cilit diagnostifikim pastaj mund të projektohen masat e duhura dhe të zhvillohet një program efektiv për reduktimin e UPF.

Në këtë kontekst, dhënia e përgjigjeve në pyetjet bazike si:

- (i) **Sa ujë humbet? (ii)**
- (ii) **Ku humbet? dhe**
- (iii) **(iii) Pse humbet?**

Është me rëndësi esenciale për adaptimin dhe implementimin e zgjidhjeve praktike për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

- (i) Shkalla e humbjeve të ujit (*Sa janë humbjat e ujit?*)

Shkalla e humbjeve të ujit për zonën e shërbimit të KRU 'Gjakova' (KRUGJ) në vitin 2016 dhe 2017, ka qenë **47 %** ose 16.7 m³/konsumator/muaj. Shprehur në vëllim kjo paraqet 7.2 milion m³ në vit!

- (ii) Kuantifikimi (përcaktimi vëllimor) i humbjeve reale dhe aparente (*Ku humbet uji?*)

Kompania aktualisht nuk është në gjendje të kuantifikojë sasinë e *humbjeve aparente* dhe *humbjeve reale* në totalin e humbjeve të ujit, megjithatë sipas të gjitha vlerësimeve humbjat aparente përbëjnë mbi gjysmën e humbjeve totale.

- (iii) Shkaqet për humbjat e ujit (*Pse humbet uji?*)

Shkaqet për këtë shkallë të lartë të humbjeve të ujit janë të ndryshme. Praktikisht të gjitha aspektet e veprimtarisë së KRUGJ kanë ndikim në humbjat e ujit: prodhimi, shpërndarja, mirëmbajtja dhe operimi, matja, leximi i ujëmatësve dhe faturimi etj.

Megjithatë, tri janë identifikuar të jenë shkaqet kryesore për shkallën e lartë të humbjeve të ujit:

- **Mosmenaxhimi i duhur.** Edhe pse humbjet e ujit janë identifikuar si prioritet i KRUGJ, deri tani nuk ka pasur strategji të zhvilluar për menaxhimin e tyre.
- **Problemet kulturore dhe sociale.** Problemet me sundimin e ligjit janë reflektuar edhe në rritjen e humbjeve të ujit në formën e kyçjeve ilegale, dëmtimin e rrjetit të ujësjellësit, manipulimin me ujëmatësa etj.
- **Problemet teknike.** Për shkak të resurseve të limituara financiare, investimet në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit kanë qenë minimale, dhe ato kryesisht të financuara nga donatorët. Për më tepër rrjeti i shpërndarjes nuk i ka të përcaktuara zonat hidraulike gjë që e vështirëson tej mase menaxhimin efektiv të humbjeve të ujit.

Trendi i UPF gjatë 4 viteve të fundit është paraqitur në figurën 2, më poshtë.

Tabela 2: Trendi i UPF Gjatë Viteve 2014-2017

Të dhëna për:	2014	2015	2016	2017
Prodhimi (milion m3)	13,527,221	13,722,261	15,247,974	14,981,619
Faturimi (m3)	6,738,313	7,077,840	8,017,860	7,963,731
UPF (m3)	6,788,908	6,644,421	7,230,860	7,017.888
UPF (%)	50%	48,00%	47.00%	46.84%

3. CAQET E PËRCAKTUARA

Nga tabela e mësipërme në figurën 2, shihet se trendi i humbjeve është në korrelacion të drejtpërdrejt me prodhimin e ujit – në vitet kur prodhimi ka qenë më i lartë kjo është reflektuar me humbje më të larta dhe anasjelltas.

Pra është evidente se rritja e prodhimit të ujit nuk shoqërohet me rritjen e proporcionale të faturimit të ujit (në përjashtim të vitit 2016, ku kemi rritje të dukshme të faturimit).

Me të drejtë shkalla e lartë e humbjeve të ujit është identifikuar si një prej problemeve kryesore me të cilat ballafaqohet KRUGJ.

Rrjedhimisht, me këtë Strategji janë përcaktuar synime ambicioze për tejkalimin e kësaj sfide.

Caqet dhe dinamika e reduktimit të UPF gjatë periudhës 2018-2022 janë dhënë në tabelën vijuese (figura 2).

Tabela 3: Synimet e Kompanisë për Zvogëlimin e UPF 2018-2022

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Prodhimi (milion m3)	15,247,974	14,981,619	14,994,903	15,525,220	15,706,975	15,825,855	16,150,800
Faturimi (milion m3)	8,017,860	7,963,731	8,394,903	8,728,585	8,956,975	9,244,450	9,695,650
UPF (milion m3)	7,230,860	7,017.89	6,600,000	6,796,635	6,750,000	6,581,405	6,455,150
UPF (%)	47.00%	46.84%	44.00%	43.78	42.97	41.59	39.97

Është e qartë se arritja e këtyre caqeve kërkon para së gjithash përkushtimin maksimal të menaxhmentit të KRUGJ, për shfrytëzimin efektiv dhe eficient të të gjitha resurseve njerëzore dhe financiare dhe mobilizimin e plotë të stafit të KRUGJ. Kjo nënkupton jo vetëm përcaktimin e prioriteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve efektive operative, por para se gjithash adaptimin e metodologjive të duhura për hulumtimin, monitorimin dhe kontrollimin sistematik të humbjeve reale dhe humbjeve aparente.

KRUGJ, synon që zvogëlimin e humbjeve në vitin 2022, ta ketë ndër 40%, por kjo varet ,sa do te financohet në ndërrimin e gypave të azbestit të cilët janë të vendosur mbi 35-40 vite.

Për arritjen e caqeve të përcaktuara KRUGJ, do të përqendrojë aktivitetet e veta në katër shtylla kryesore:


- (i) Matja e plotë dhe e saktë e ujit të konsumuar;
- (ii) Eliminimi i të gjitha parregullsive të lidhura me faturimin e saktë në bazë të konsumit real të konsumatorëve;
- (iii) Identifikimi dhe legalizimi/shkyçja e të gjitha kyçjeve të paligjshme;
- (iv) Detektimi dhe riparimi sistematik i të gjitha rrjedhjeve si dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).

4. REDUKTIMI I HUMBJEVE APARENTE

Në parim humbjet aparente (ose siç njihen edhe si *humbjet komerciale*) përfshijnë:

- Shfrytëzimin e paautorizuar të ujit (vjedhja e ujit)
 - Kyçjet ilegale
 - Manipulimi me ujëmatës
 - Vendrrjedhjet para ujëmatësit
- Gabimet në leximin e ujëmatësve
- Gabimet në faturim
- Pasaktësinë e regjistrimit të ujëmatësve
- Faturimin pa ujëmatës (paushall)

Figura 1: Metodologjia e IWA-s, për Kontrollimin e Humbjeve Aparente



Prioriteti kryesor i Kompanisë në zvogëlimin e humbjeve të ujit është reduktimi i humbjeve aparente. Luftimi me sukses i këtyre humbjeve paraqet sfida për menaxhmentin e Kompanisë dhe presupozon ballafaqimin me sukses me tri elementet menaxhuese:

- ***Menaxhimin e resurseve njerëzore (punëtorëve)***
- ***Menaxhimin e resurseve fizike (pajisjeve, para së gjithash ujëmatësve)***
- ***Menaxhimin e resurseve organizative (procedurat)***

Reduktimi i këtyre humbjeve nuk kërkon investime financiare të larta por para se gjithash përkushtim maksimal të menaxhmentit, prandaj mund të arrihen rezultate të konsiderueshme përmes ndërmarrjes së masave si:

- inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit,
- shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht ose që vjedhin ujin,
- instalimi i ujëmatësve aty ku mungojnë,
- kalibrimi i ujëmatësve të dyshimtë,
- inspektimi i rregulltë dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional,
- ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve,
- kontrollimi i leximeve nga kontrolli, etj

4.1. Synimet Operative për Reduktimin e Humbjeve Aparente

Për të përmbushur caqet e përcaktuara sa i përket zvogëlimit të humbjeve të ujit në nivelet e planifikuara, KRUGJ, ka përcaktuar synimet specifike operative të cilat do të angazhohet ti përmbushë përmes aktiviteteve konkrete të planifikuara për arritjen e secilit prej synimeve operative veç e veç.

1. **Konsolidimi i databazës së konsumatorëve:** Identifikimi, inçizimi dhe regjistrimi i të gjithë konsumatorëve në tërë zonën e shërbimit të KRUGJ;
2. **Eliminimi i lidhjeve ilegale dhe formave tjera të shfrytëzimit të paautorizuar të Ujit;**
3. **Faturimi i konsumatorëve që reflekton saktësisht ujin e konsumuar:** Instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së matjes dhe leximit.

4.2. Aktivitetet e Planifikuara

Për secilin prej synimeve operative lidhur me reduktimin e humbjeve aparente KRUGJ, ka përcaktuar aktivitete konkrete si dhe afatet kohore respektive.

Synimi 1: **Konsolidimi i databazës së konsumatorëve – identifikimi, inçizimi dhe regjistrimi i të gjithë konsumatorëve në tërë zonën e shërbimit.**

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 1:

- (i) Incizimi kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve nga ekipet e KRUGJ.
KRUGJ, me ekipet e veta të Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit –Sektori i Gjeodezisë dhe Sektori i mirëmbajtjes do të inçizojë të gjitha kyçjet (rreth 36,000) dhe ujëmatësat në periudhën 2018-2020.
- (ii) Kontraktimi i incizimit të kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve.
KRUGJ, planifikon që të angazhojë ekipet e kontrollës dhe çkyqjes për inçizimin e 35,000 kyçjeve shtëpiake dhe ujëmatësve gjatë viteve 2018 dhe 2021.

- (iii) Azhurnimi sistematik i të dhënave të inçizuara në terren në databazën e konsumatorëve nga Operatorët e GIS-it.

Kjo databazë do të jetë e ndërlidhur me sistemin e GIS. Ky aktivitet do të jetë permanent dhe do të zhvillohet gjatë tërë periudhës së përfshirë me këtë strategji. Gjatë vitit 2018, do të sigurohet edhe softweri për databazën e përcaktimit të vlefshmërisë të gypave të ujësjellsit. Me këtë softwer do të jetë e mundur që në qdo moment të kemi gjendjen reale të infrastrukturës ujore në GIS. Në këtë data bazë do të kenë mundësi që të kenë qasje i tërë menagjimenti i lartë. Kështu që në mënyrë reale do të përcaktohet gjendja reale (kritike dhe e mirë) e rrjetit që duhet të ndrrohet ose të mos ndrrohet.

Verifikimi i të gjitha rasteve të cilat aktualisht nuk faturohen

KRUGJ, planifikon të formojë një komision i cili do të verifikojë të gjitha rastet e konsumatorëve të cilët aktualisht nuk faturohen. Konform gjetjeve të këtij komisioni do të bëhet azhurnimi i databazës së konsumatorëve. Ky aktivitet planifikohet të realizohet gjatë vitit 2018 me resurset e KRUGJ.

Synimi 2: Eliminimi i kyçjeve ilegale dhe formave tjera të shfrytëzimit të paautorizuar të ujit.

Gjendja aktuale:

- (i) Aktualisht KRUGJ nuk ka informacion se sa është numri i konsumatorëve të kyçur ilegalisht në rrjetin e ujësjellsit dhe të atyre konsumatorëve që faturohen sipas leximit të ujëmatësit por që kanë lidhje të ujit jashtë ujëmatësit (vjedhin ujin). KRUGJ, vlerëson se numri i konsumatorëve të kyçur ilegalisht (të paregjistruar/që nuk faturohen) është rreth 3-4%.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 2:

- (i) Zbulimi dhe raportimi i kyçjeve ilegale nga lexuesit e ujëmatësve
Të gjithë lexuesit e ujëmatësve do të kenë përgjegjësinë për raportimin e kyçjeve ilegale në terrenin e tyre. KRUGJ, do të aplikojë një skemë me të cilën do të ndëshkojë Lexuesit e Ujëmatësve për mos-raportimin e kyçjeve ilegale. Por do të i stimuloi ata të cilët do të kryejn raportimin dhe zbulimin e kyçjeve ilegale. Ky aktivitet do të jetë permanent.
- (ii) Zbulimi dhe raportimi i kyçjeve ilegale nga kontrollat e KRUGJ
KRUGJ, planifikon që në periudhën 2018-2022 përmes Njesisë së kontrollës të inspektojë sistematikisht zonën e shërbimit të KRUGJ, me qëllim të zbulimit të

kyçjeve ilegale. Ky aktivitet do të jetë permanent dhe do të zhvillohet me resurset e brendshme të KRUGJ.

- (iii) Regjistrimi dhe fillimi i faturimit të konsumatorëve të kyçur ilegalisht
Të gjitha kyçjet ilegale të zbuluara do të legalizohen dhe regjistrohen (nëse i plotësojnë kushtet për legalizim) apo shkyçen (nëse nuk i plotësojnë kushtet për legalizim), në të dyja rastet në pajtim me Ligjin dhe procedurat e KRUGJ.

- (iv) Zbulimi dhe eliminimi i vjedhjeve të ujit

Zbulimi i vjedhjeve të ujit (lidhjet para ujëmatësit) planifikohet të zhvillohet në dy forma:

- 1.nga ekipet të cilat inçizojnë kyçjet shtëpiake dhe ujëmatësit, dhe*
- 2.nga ekipet e kontrolles.*

KRUGJ, për të qenë më të saktë në gjetjen e kyçjeve ilegale ka planifikuar që në vitin 2018, të siguroi detektor me anë të cilit do të mund të detektoi deri në 6m thellësi gypat e ujit të diametrave të ndryshëm.Kështu që me këtë detektor mund të detektohen gypat ilegal aty ku dyshohet se mund të ekzistojnë

Pas zbulimit të këtyre rasteve do të vepohet në pajtim me procedurat e KRUGJ, për kyçjet Ilegale dhe Shfrytëzimin e Pa-autorizuar të Ujit. Ky aktivitet do të jetë permanent.

Synimi 3: Faturimi i konsumatorëve që reflekton saktësisht ujin e konsumuar: instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së matjes dhe leximit.

Gjendja aktuale:

Aktualisht (gjendja e fundvitit 2016) shkalla e matjes së konsumit të ujit është 97%. Nga numri total i 35,600 konsumatorëve aktiv (që faturohen), 35,000 faturohen në bazë të ujëmatësit.

Në anën tjetër, edhe sa i përket leximit të ujëmatësve, KRUGJ, konsideron se saktësia e leximit të tyre nuk është në nivelin e duhur. Kjo konfirmohet nga Raportet e ARRU.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 3:

- (i) Blerja dhe instalimi i 5,000 ujëmatësve te ri për zëvendësimin e ujëmatësve jofunksional. Nga kjo shifër planifikohen 1.000 ujëmatës të menqur kurse 4.000 të tjerë të thjeshtë me mundësi që në të ardhmen të lexohen nga largësia.

Duke filluar nga Janari 2018, KRUGJ, do të zhvillojë kontrollimin sistematik të saktësisë së matjes të ujëmatësve dhe zëvendësimin e ujëmatësve jofunksional dhe të pasaktë. Kjo punë do të kryhet përmes katër formave:

- a. *Kontrollimi vizuel nga ana e lexuesve të ujëmatësve dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional;*
- b. *Kontrollimi në terren nga ana e kontrolles dhe zëvendësimi i ujëmatësve të pasaktë/jofunksional;*
- c. *Zëvendësimi sistematik i ujëmatësve të vjetër (ujëmatësit më të vjetër se 7 vite) në bazë të procedurave të KRUGJ për ujëmatësit.*
- d. *Aktivizimi i linjës së kalibrimit për ujëmatësat Ø 3/4" dhe Ø 1", dhe më këtë të kalibrohen të gjithë ujëmatësat të cilët mund të kalibrohen deri më Dhjetor të 2022*

Për këtë qëllim KRUGJ, do të blejë dhe zëvendësojë 22,000 ujëmatës gjatë periudhës 2018-2022. Në vitin 2018, do të zëvendësohen vetëm ujëmatësit jofunksional (rreth 5,000) ndërkaq duke filluar prej vitit 2019, do të zhvillohet një program për zëvendësimin e të gjithë ujëmatësve më të vjetër se 7 vite (18,000).

(ii) Kontrollimi sistematik i saktësisë së leximit të ujëmatësve

KRUGJ, në vitin 2018, do të angazhojë personel shtesë me kontratë apo do të kontraktojë një kompani, për kontrollimin sistematik të saktësisë së leximit të ujëmatësve. Ku dyshohet për një pasaktësi të leximit të ujëmatëve. Duke pasur këtë parasysh, KRUGJ, do të vazhdojë këtë aktivitet – kontrollimin e saktësisë së leximit – edhe gjatë viteve në vijim përmes kontraktorëve të jashtëm si dhe ekipeve të inspektimit të KRUGJ. Secila prej ekipeve duhet të inspektojë rreth 5,500 konsumator në vit.

(iii) Inicimi i procesit të leximit të ujëmatësve nga distanca

Në vitin 2018 KRUGJ, do të fillojë me instalimin e pajisjeve për leximin e ujëmatësve nga distanca (leximi automatik i ujëmatësve). Ky aktivitet fillimisht do të realizohet në një pilot zonë në komunën e Gjakovës, dhe do të përfshijë kryesisht konsumatorët e vegjël komercial (3500) gjatë 3 viteve të para. Deri në fund të vitit 2022 KRUGJ, planifikon që 20% e konsumatorëve të vet (rreth 7000) të faturohen në bazë të leximit nga distanca.

(iv) Instalimi i ujëmatësve individual në objektet e banimit kolektiv

Aktualisht, rreth 600 konsumatorë në objektet e banimit kolektiv faturohen në bazë të ujëmatësve kolektiv (të përbashkët). Duke pasur parasysh se kjo formë e faturimit shkakton pakënaqësi të konsumatorëve dhe njëkohësisht nuk i stimulon ata për kursimin e ujit, KRUGJ, do të zhvillojë një program për instalimin e ujëmatësve individual te konsumatorët në objektet e banimit kolektiv.

Ky program do të përfshijë tri lloje të masave:

- a) Kontrollimin dhe instalimin/zëvendësimin e 7,000 ujëmatësve individual në ato objekte ku ekzistojnë ujëmatësit individual por që aktualisht nuk lexohen.

Shpenzimet e instalimit të ujëmatësve individual do të ngarkohen konsumatorëve. Ky aktivitet planifikohet të fillohet në fund të Tetorit 2018 dhe vazhdon në vitin 2019.

- b) Imponimin e rregullt që në objektet e reja të banimit kolektiv të gjitha njësitë (konsumatorët) të kenë ujëmatës individual.

Kjo rregull do të aplikohet në mënyrë strikte nga fillimi i vitit 2018.

- c) Në rastin e objekteve të vjetra të banimit kolektiv ku nuk ekzistojnë ujëmatësit individual do të ofrohet mundësia për konsumatorët që të instalojnë ujëmatësin e tyre individual.

Shpenzimet e instalimit të ujëmatësve individual do ti bartin konsumatorët. Ky aktivitet do të zhvillohet duke filluar nga gjysma e vitit 2018 dhe do vazhdon në vitin 2019.

(v) Krijimi i databazës së ujëmatësve dhe azhurnimi i rregulltë i saj KRUGJ, planifikon që ta konsolidojë databazën e ujëmatësve dhe ta azhurnojë rregullisht atë. Databaza e ujëmatësve do të jetë e integruar me databazën e konsumatorëve dhe do të shërbejë si bazë për ndërrimin e rregulltë të ujëmatësve të vjetër dhe riparimin e tyre.

(vi) Pllombimi i të gjithë ujëmatësve
Me qëllim të parandalimit të manipulimit me Ujëmatësa, ekipet e kontrolles do të kontrollojnë rregullisht pllombat e ujëmatësve dhe aty ku mungojnë do të vendosen pllombat e KRUGJ. Ky aktivitet do të filloi në vitin 2018 dhe planifikohet të kryhet brenda 24 muajve.

Tabela 1: Aktivitetet e Planifikuara për Reduktimin e Humbjeve Aparente (komerciale dhe Treguesit e Matshëm

Synimet Operative	Aktivitetet e Planifikuara	Treguesit e Matshëm	Departamentet Përgjegjëse	Afatet Kohore	
SYNIMI 1: Konsolidimi i databazës së konsumatorëve – identifikimi, incizimi dhe regjistrimi i të gjithë konsumatorëve në tërë zonën e shërbimit.	(i)	Inçizimi i 36,000 kyçeve dhe ujëmatësve nga ekipet e KRUGJ	36,000 kyçe dhe ujëmatës janë inçizuar në terren nga ekipet e KRUGJ (6,000 në vit)	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i GIS 	Janar 2018 - Dhjetor 2020
	(ii)	GIS: Regjistrimi i të dhënave nga matjet e terrenit në sistemin e GIS	Të gjitha të dhënat nga matjet e terrenit janë regjistruar në sistemin e GIS	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i GIS 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	(iii)	Azhurnimi i databazës së Konsumatorëve	Databaza e konsumatorëve është azhurnuar dhe pastruar nga konsumatorët pasiv (që nuk faturohen)	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtori Financiar • Dept. i Shitjes 	Mars 2018 - Dhjetor 2018
	a)	Formimi i Komisionit për shqyrtimin e rasteve të konsumatorëve pasiv/ inekzistent	Komisioni për shqyrtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konsumatorëve pasiv është themeluar.	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtori Financiar • Dept. i Shitjes 	Mars 2018
	b)	Verifikimi në terren i rasteve problematike/kontestuese	Janë identifikuar dhe verifikuar në terren të gjitha rastet kontestuese dhe është hartuar raporti për statusin e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Njësia e Inspektimit 	Prill 2018 - Tetor 2018
	c)	Shqyrtimi i detajuar dhe marrja e vendimit për shlyerjen ose faturimin (sipas rastit) të konsumatorëve pasiv (që nuk faturohen)	Është definuar statusi i të gjithë konsumatorëve pasiv dhe është marre vendim për shlyerjen ose faturimin e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtori Financiar • Dept. i Shitjes 	Mars 2018 - Tetor 2018
	d)	Azhurnimi/pastrimi i databazës së konsumatorëve	Në databazën e konsumatorëve nuk ka konsumatorë pasiv - të cilët nuk faturohen	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtori Financiar • Dept. i Shitjes 	Nëntor - Dhjetor 2018

SYNIMI 2: Eliminimi i Kycjeve Ilegale dhe Konsumit të Paautorizuar	(i)	Zbulimi dhe raportimi i kycjeve ilegale nga Lexuesit e Ujëmatësve	Lexuesit e ujëmatësve raportojnë rregullisht kycjet ilegale në terrenin e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Shërbimi i Leximit 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	(ii)	Zbulimi dhe raportimi i kycjeve ilegale nga Ekipet e Inspektimit	Raportet ditore, javore, mujore dhe vjetore të Ekipeve të inspektimit	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Njësia e Inspekt. 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	(iii)	Legalizimi dhe fillimi i faturimit të konsumatorëve ilegal	Të gjitha kycjet ilegale të raportuara nga Lex. e Ujëm. dhe Ekipet e Insp. regjistrohen dhe faturohen	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Shërbimi i Fat. 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	(iv)	Zbulimi dhe eliminimi i vjedhjeve të ujit	Raportet ditore, javore, mujore dhe vjetore të Ekipeve të inspektimit	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Njësia e Inspekt. 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	(v)	KRUGJ për të qenë më të saktë në gjetjen e kycjeve ilegale ka planifikuar që në vitin 2018 të siguroi detektor me anë të cilit do të mund të detektoi deri në 6m thellësi gypat e ujit të diametrave të ndryshëm. Kështu që me këtë detektor mund të detektohen gypat ilegal aty ku dyshohet se mund të ekzistojnë	Të gjitha kycjet ilegale të raportuara nga Lexuesit e Ujëmatësve dhe Ekipet e kontrolles, regjistrohen dhe faturohen	<p>Departamenti Teknik Departamenti Financiar</p>	Janar 2018- Dhjetor 2022

Tabela 2: Aktivitetet e Planifikuara për Reduktimin e Humbjeve Aparente (Komerçiale) dhe Treguesit e Matshëm

SYNIMI 3: Faturni i konsumatorëve që reflekton saktësisht ujin e konsumuar: instalimi i ujëmatësve për të gjithë konsumatorët dhe sigurimi i saktësisë së maties dhe leximit.	(i)	Blerja dhe instalimi i 5,000 ujëmat. të ri nga KRUGJ për zëvendësimin e ujëmatësve të vjetër	5,000 ujëmatës të ri janë blerë dhe instaluar në vend të ujëmatësve jofunksional	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Prokurimit 	Mars 2018 - Dhjetor 2022
	a	Përgatitja dhe zhvillimi i procesit të prokurimit të 8000 ujëmatësve të ri	Janë blerë 5,000 ujëmatës të ri të profileve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Prokurimit 	Janar 2018 - Prill 2018
	b	Demontimi i ujëmatësve të vjetër dhe atyre jofunksional dhe montimi i ujëmatësve të ri	Janë instaluar 5,000 ujëmatës të ri në vend të atyre të vjetër dhe jofunksional	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Ujëmat. 	Prill 2018 - Dhjetor 2022
	c	<i>Aktivizimi i linjës së kalibrimit për ujëmatësat Ø 3/4" dhe Ø 1" dhe më këtë të kalibrohen të gjithë ujëmatësat të cilët mund të kalibrohen deri më 2022</i>	Janë kalibruar dhe instaluar 18,000 ujëmatës të ri në vend të atyre të vjetër dhe jofunksional	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Ujëmat. 	Prill 2018 - Dhjetor 2022
	(ii)	Kontrollimi i saktësisë së leximit të ujëmatësve	Raportet ditore, javore, mujore dhe vjetore të Ekipeve të inspektimit	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Njësia e Inspekt. 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
	a	Angazhimi i personelit shtesë me kontratë mbi vepër për kontrollimin e saktësisë së leximit të ujë matësve	Janë angazhuar me kontratë mbi vepër 50 studenta/profesionist të ri dhe janë udhëzuar për punën që duhet ta kryejnë për të gjitha NJO.	<ul style="list-style-type: none"> • Kryesh. ekzekutiv • Drejtori financiar • Menaxh. e NJO 	Mars 2018
	b	Kontrollimi sistematik i saktësisë së leximit të ujëmatësve nga ekipet e inspektimit	Raportet ditore, javore, mujore dhe vjetore të Ekipeve të inspektimit në të gjitha NJO	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Njësia e Inspektimit 	Janar 2018 - Dhjetor 2018


	(iii)	Inicimi i procesit të leximit të ujëmatësve nga distanca	Blerja dhe instalimi i 10,000 ujëmatësve të tipit 'smart meters' për leximin nga distanca	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Prokurimit 	Mars 2018 - Dhjetor 2022
	(iv)	Instalimi i ujëmatësve individual në ndërtesat e banimit kolektiv	Është kompletuar programi i instalimit të ujëmatësve individual në ndërtesat kolektive	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Dep. i Ujëmat. 	Nëntor 2018 - Dhjetor 2022
	(v)	Krijimi i databazës së Ujëmatësve dhe azhurnimi i rregulltë i saj	Databaza ekzistuese e ujëmatësve është konsoliduar dhe azhurnohet rregullisht	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Dept. i Ujëmatësve 	Janar 2018 - Qershor 2018
	(vi)	Pllombimi i rregulltë i ujëmatësve	Të gjithë ujëmatësit e konsumatorëve janë kontrolluar dhe pllombuar	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Ujëmat. • Njësia e Inspekt. 	Mars 2018 - Mars 2020
	a	Zhvillimi i fushatës për informimin e konsumatorëve për mundësinë e instalimit të ujëmatësve individual në ndërtesat kolektive	Te gjithë konsumatorët në objektet e banimit kolektiv janë informuar për mundësinë e instalimit të ujëmatësve individual	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Zëdhënësi i KRUGJ 	Nëntor 2018 - Shkurt 2019
	b	Demontimi i ujëmatësve të vjetër dhe montimi i ujëmatësve të ri në objektet e banimit kolektiv	Të gjithë ujëmatësit e vjetër dhe jofunksional në banesat individuale janë zëvendësuar me të rinjë	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Dept. i Ujëmat. 	Mars 2019 - Tetor 2020
	c	Instalimi i ujëmatësve individual në objektet e banimit kolektiv me kërkesë të konsumatorëve	Janë instaluar ujëmatësit individual tek të gjithë konsumatorët që kanë aplikuar dhe kryer pagesën	<ul style="list-style-type: none"> • Dept. i Shitjes • Dept. i Ujëmat. 	Mars 2019 - Dhjetor 2022

5. REDUKTIMI I HUMBJEVE REALE (FIZIKE)

Task Forca për Humbjet e Ujit e IWA-s, e ka zhvilluar një model për menaxhimin e rrjedhjeve (humbjeve reale) që konsiston në 4 aspekte, dhe është paraqitur në fig. 3.

Një strategji e veçante mbi të cilën duhet të mbështeten të gjitha aktivitetet e kontrollit të rrjedhjeve është konfigurimi i rrjetit. Në këtë kontekst, duhet të krijohen zonat e matjes – DMA (*'District Metered Areas'*) e pranuar përgjithësisht si forma më e përshtatshme për monitorimin dhe menaxhimin e humbjeve reale.

Figura 3: Qasja e kontrollimit të rrjedhjeve sipas Task Forcës së IWA-s, për Humbjet e Ujit



Reduktimi i këtyre humbjeve kërkon investime financiare të konsiderueshme dhe njëkohësisht edhe përkushtim maksimal të menaxhmentit. Duke pasur parasysh mundësitë e limituara financiare të KRUGJ, aktualisht pjesa më e madhe e investimeve kapitale në reduktimin e humbjeve reale po financohen nga donacionet që i përfiton KRUGJ para së gjithash prej Bankës Gjermane për Zhvillim (KFW) por edhe Komisionit Evropian, USAID, DORCH/CDI, dhe donatorëve tjerë.

Aktiviteti i KRUGJ, në reduktimin e humbjeve reale të ujit do të përqendrohet në masat:

Faza e I-rë: 2018-2020

- (i) Riparimi efektiv i rrjedhjeve të dukshme,
- (ii) Detektimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme dhe riparimi i tyre,
- (iii) Rehabilitimi/zëvendësimi i rrjetit të vjetruar me asistencën e donatorëve
- (iv) Definimi dhe krijimi i zonave të matura (DMA)
- (v) Menaxhimi i presioneve

Faza e II-të: (2020 +)

- (i) Monitorimi i humbjeve në zonat e matura
- (ii) Përcaktimi i saktë i bilancit ujor
- (iii) Menaxhimi i presioneve
- (iv) Rehabilitimi sistematik i rrjetit dhe kyçjeve shtëpiake

5.1 Synimet Operative për Zvogëlimin e Humbjeve Reale/Fizike

Për të përmbushur caqet e përcaktuara sa i përket zvogëlimit të UPF në nivelet e planifikuara me Planin e Biznesit 2018-2020 dhe me këtë strategji, KRUGJ, ka përcaktuar synimet specifike operative për reduktimin e humbjeve reale (rrjedhjeve) të cilat do të angazhohet ti përmbushë përmes aktiviteteve konkrete të planifikuara për arritjen e secilit prej synimeve operative veç e veç.

1. Krijimi i një sistemi efektiv për identifikimin dhe riparimin e shpejtë të rrjedhjeve të dukshme (mbitokësore);
2. Hulumtimi, detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore);
3. Rehabilitimi (zëvendësimi) i infrastrukturës së vjetruar të ujësjellësit (kyçjeve shtëpiake dhe rrjetit);
4. Krijimi i zonave të matura (DMA-ve) për menaxhimin efektiv të UPF;
5. Rishikimi dhe ridefinimi i zonave të presionit.

5.2 Aktivitetet e Planifikuara

Synimi 4: Krijimi i një sistemi efektiv për identifikimin dhe riparimin e shpejtë të rrjedhjeve të dukshme.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 4:

- (i) Aplikimi i skemës stimuluese për raportimin e rrjedhjeve të ujit
Duke filluar nga Janari i vitit 2018 KRUGJ, do të hartojë dhe aplikojë një skemë stimuluese për të gjithë ata (qytetarët ose stafin e KRUGJ) të cilët raportojnë për rrjedhjen e ujit. Stimulimi do të konsistojë në pagesën simbolike (p.sh. 1 EUR) për secilën rrjedhje të raportuar dhe të konstatuar.
- (ii) Hapja e linjës telefonike për raportimin e rrjedhjeve pa pagesë
Prej Janarit 2018, KRUGJ, do ta inaugurojë një numër të veçantë të telefonit përmes të cilit qytetarët do të mund të raportojnë rrjedhjet e ujit 24 orë në ditë. KRUGJ, ka siguruar zgjidhjen që thirrjet telefonike të bëhen në numër pa pagesë.
- (iii) Vendosja e standardit për riparim brenda 24 orëve të rrjedhjeve të raportuara

Me qëllim të shkurtimit të kohës së nevojshme për riparimin e rrjedhjeve, KRUGJ, do të vendosi dhe zbatojë standardin për *riparimin e rrjedhjeve të raportuara brenda 24 orëve* prej momentit të raportimit të tyre.

Ky standard do të aplikohet për të gjitha rrjedhjet me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë operacione ekstensive në vëllim dhe material ose leje të posaçme për intervenim nga autoritetet përkatëse.

(iv) Ngritja e cilësisë së materialeve të përdorura dhe të punëve montuese

Duke pasur parasysh se cilësia e materialeve të përdorura dhe cilësia e montimit të tyre është faktori kryesor që ndikon në shkallën e humbjeve fizike të ujit, KRUGJ, do të kushtojë rëndësi të veçantë kësaj çështje. Për adresimin adekuat të këtij problemi KRUGJ, do të ndërmer veprimet vijuese:

- Përdorimin e materialeve të kualitetit më të lartë të cilat janë të certifikuar dhe atestuara për ndërtimin, rehabilitimin apo riparimin e rrjetit të ujësjes;
- Kontrollimin dhe aprovimin paraprak të materialeve në rastet kur punimet kryhen nga kontraktorët e jashtëm të financuar qoftë nga KRUGJ, apo institucionet tjera
- Instalimi i kyçjeve shtëpiake duke përfshi materialin dhe punët instaluese do të bëhet ekskluzivisht nga KRUGJ.

Për këtë qëllim KRUGJ do të përcaktojë standardin e kualitetit dhe specifikimet teknike të materialeve që mund të përdoren për rrjetin e ujësjes.

Këto standarde do të jenë të obligueshme për projektimin dhe për prokurimin e materialit për nevojat e zgjerimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjes dhe të kyçjeve shtëpiake.

Synimi 5: Hulumtimi detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore).

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 5:

- (i) Ndarja zonës së shërbimit në katër nën-zona (Qyteti i Gjakovës, fshatrat e Gjakovës, Njësia e Rahovecit dhe Njësia e Lumbardhit)
E tërë zona e shërbimit të KRUGJ, do të ndahet në dy nën-zona (Gjakova me fshatra dhe Rahoveci me Lumbardhin) të cilat do të jenë nën përgjegjësi të dy ekipeve të detektimit të rrjedhjeve. Njëkohësisht do të kompletohet me aparaturë më bashkëkohore të detektimit si dhe me personelin e duhur (minimum do të shtohen edhe dy punëtor të trajnuar)
- (ii) Kontrollimi sistematik i rrjetit me qëllim të zbulimit të rrjedhjeve nëntokësore (të padukshme)

Spektori i Detektimit të Rrjedhjeve (i kompletuar me aparaturë dhe me personel shtesë të trajnuar) do të zhvillojë një plan të kontrollimit pro-aktiv të rrjedhjeve. Ky plan do të përcaktojë që secili prej 2 ekipeve duhet që në afat prej 2 viteve ta kontrollojë tërë nën-zonën e vet të përgjegjësisë.

Në këtë mënyrë *në periudhën 2018-2022, i tërë rrjeti do të kontrollohet 2 herë*. Ky kontroll do të përfshijë zbulimin dhe raportimin e rrjedhjeve të dukshme si dhe detektimin dhe raportimin e rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore).

- (iii) Vendosja e standardit për riparimin brenda 7 ditëve të të gjitha rrjedhjeve të raportuara

KRUGJ do të vendosë dhe zbatojë standardin për *riparimin e rrjedhjeve të nëntokësore të detektuara brenda 7 ditëve prej momentit të raportimit* të tyre. Ky standard do të aplikohet për të gjitha rrjedhjet me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme të cilat kërkojnë operacione ekstensive në vëllim dhe material ose leje të posaçme për intervenim nga autoritetet përkatëse.

Synimi 6: Zëvendësimi i infrastrukturës së vjetruar të ujësjellësit (rrjetit shpërndarës dhe kyçjeve shtëpiake).

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 6:

- (i) Rehabilitimi/zëvendësimi i 4,000 kyçjeve shtëpiake
Në periudhën 2018 KRUGJ, do të *zëvendësojë 4000 kyçje shtëpiake*.
- (ii) Rehabilitimi/zëvendësimi i 24.624 metra rrjetit shpërndarës të ujësjellësit bazuar në planin e menaxhimit të aseteve dhe kriteret e shërbyeshmërisë së rrjetit.

Gjatë viteve 2018 – 2019 KRUGJ, do të *zëvendësojë 24624 metra rrjet të ujësjellësit në pjesët e ndryshme të rrjetit kryesor dhe shpërndarës*. Rrjeti i ujësjellësit për tu zëvendësuar identifikohet bazuar në vlerësimin e bazuar në vjetërsinë, materialit (Azbest) dhe shërbyeshmërinë e rrjetit e në funksion të reduktimit të humbjeve fizike të ujit. Kjo synohet të realizohet nga kompania dhe donatorët. Gjithashtu në baze të negociatave planifikohet edhe ndërtimi i gypit të azbest cimentos **26.484 m**, në qytetin e Gjakovës nga donatorët.

Synimi 7: Krijimi i zonave të matura (DMA-ve) për menaxhim efektiv të humbjeve të ujit.

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 7:

- (i) Definimi i Zonave të Matura – DMA-ve

Aktualisht KRUGJ, është në përfundim të procesit të definimit të zonave të matura (DMA-ve). Ky proces pritet të përfundojë në 6-mujorin e parë të vitit 2018. Madhësia e DMA-ve do të përcaktohet konform udhëzimeve të IWA-së, për madhësinë optimale të DMA-ve

(rreth 3,000 kyçje) por duke pasur parasysh njëkohësisht specifikat e sistemit të ujësjellësit të KRUGJ.

Duke u nisur nga specifika e KRUGJ kemi DMA edhe më të vogla si psh një fshat në vete është një DMA edhe pse ka shumë më pak konsumator

(ii) Monitorimi i UPF në kuadër të DMA-ve dhe përcaktimi i saktë i bilancit ujqor për KRUGJ

Pas përfundimit të krijimit të DMA-ve, në fillim të vitit 2020, KRUGJ do të zhvillojë monitorimin kualitativ të UPF në kuadër të DMA-ve, që do të mundësojë kuantifikimin e saktë të komponentëve të UPF dhe rrjedhimisht përcaktimin e saktë të bilancit ujqor. Në pajtim me gjetjet e këtij bilanci do të rishikohet edhe strategjia e reduktimit të UPF.

Synimi 8: Menaxhimi i presioneve

Aktivitetet e planifikuara për arritjen e synimit 8:

(i) Rishikimi dhe ridefinimi i zonave të presionit

Aktualisht në zonën e shërbimit të KRUGJ, ka nënzona ku presionet janë jashtëzakonisht të larta (mbi 7bar). Duke pasur parasysh efektin që kanë presionet e larta në intensitetin e humbjeve të ujit, KRUGJ, do të rishikojë zonat e presionit me qëllim të optimizimit të presioneve dhe menaxhimit të tyre. Për këtë qëllim KRUGJ, do të tentojë të mbajë presionet në rrjetë prej 2-4 bar.

(ii) Funksionalizimi i zonave të reja të presionit përmes punëve teknike operative (instalimi i pajisjeve për reduktimin e presionit për zonat e ridefinuara)

Pas ridefinimit të zonave të presionit në komunën e Gjakovës, Rahovecit dhe Lumbardhit, ku presionet janë të larta, do të ndërmerren punët e nevojshme operative/teknike për krijimin dhe funksionalizimin e zonave të reja me qëllim të menaxhimit adekuat të presioneve.

Për të caktuar me saktësi zonat e presionit të lartë KRUGJ ka filluar aktivitetin për përgatitjen e ToR për hapjen e procedurave tenderuese për të ekzekutuar fizibilitetin e Menagjimit të Presionit në të gjithë sistemin e ujësjellësit .Ky proces pritet të filloi në mars të vitit 2018

Tabela 3: Aktivitetet e Planifikuara për Reduktimin e Humbjeve Reale (Fizike) dhe Treguesit e Matshëm

Synimet Operative	Aktivitetet e Planifikuara		Treguesit e Matshëm	Departamentet Përgjegjëse	Afatet Kohore
SYNIMI 4: Krijimi i një sistemi efikas për identifikimin dhe riparimin e rrjedhjeve të dukshme.	(i)	Aplikimi i skemës stimuluese për raportimin e rrjedhjeve	Është aprovuar dhe zbatohet vendimi për stimulimin e atyre që raportojnë rrjedhjet	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Drejtori Financiar - ZLF 	Janar 2018
	(ii)	Ekziston linja telefonike për raportimin pa pagesë të rrjedhjeve te ujit	KRUGJ e ka funksionale linjën telefonike për raportimin pa pagesë të rrjedhjeve	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Zyrtari i Lartë Financiar 	Janar 2018
	(iii)	Vendosja e standardit për riparimin brenda 24 h të rrjedhjeve të raportuara	Është vendosur dhe zbatohet standardi për riparimin e rrjedhjeve të raportuara	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Prill 2018
	(iv)	Ngritja e cilësisë së materialeve të përdorura dhe punëve montuese	Janë përcaktuar dhe zbatohen standardet e materialit dhe punës për rrjetën e ujësjell.	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Menaxheri i Rrjetit 	Prill 2018
SYNIMI 5: Detektimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve të padukshme.	(i)	Ndarja e zonës së shërbimit në 4 nën-zona	E tërë zona e shërbimit të KRUGJ është ndarë në 4 nën-zona	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Menaxheri i Rrjetit 	Janar 2018
	(ii)	Kontrollimi sistematik i rrjetit me qëllim të zbulimit të rrjedhjeve nëntokësore	Detektimi i rrjedhjeve është kryer në tërë gjatësinë e rrjetit të ujësjellësit	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik • Men. i Detek. te Rrjedhj. 	Janar – Dhjetor 2018-2020
	(iii)	Vendosja e standardit për riparimin brenda 7 ditëve të rrjedhjeve të detektuara	Është vendosur dhe zbatohet standardi për	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv 	Prill 2018

			riparimin e rrjedhjeve të raportuara	<ul style="list-style-type: none"> • Departamenti Teknik 	
SYNIMI 6: Rehabilitimi i infrastrukturës së vjetruar të ujësjellësit	(i)	Rehabilitimi/zëvendësimi i 4,000 kyçjeve shtëpiake	Janë kryer dhe pranuar punimet për zëvendësimin e 4,000 kyçjeve shtëpiake	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2018 - Qershor 2022
	(ii)	Rehabilitimi/zëvendësimi i 24.624 metra rrjetë të ujësjellësit	Janë kryer dhe pranuar punimet për zëvendësimin e 24.624 m rrjet të ujësjellësit	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2018 - Dhjetor 2022
SYNIMI 7: Krijimi i zonave të matura (DMA)	(i)	Definimi dhe krijimi i zonave të matura (DMA)	Janë definuar zonat matëse – DMA	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2018 - Dhjetor 2019
	(iii)	Monitorimi i UPF në kuadër të DMA-ve dhe përcaktimi i saktë i bilancit uhor	Është përpiluar bilanci uhor në bazë të analizave të kryera në zonat matëse	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2020 - Dhjetor 2022
SYNIMI 8: Menaxhimi i presioneve .	(i)	Rishikimi dhe ridefinimi i zonave të presionit.	Janë definuar zonat e reja të presionit.	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2018 - Dhjetor 2018
	(ii)	Për të caktuar me saktësi zonat e presionit të lartë KRUGJ, ka filluar aktivitetin për përgatitjen e ToR për të ekzekutuar fizibilitetin e Menagjimit të Presionit në të gjithë sistemin e ujësjellësit.	Është siguruar konsulenti për menagjimin e presionit në rrjetën e ujësjellësit	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik 	Janar 2018 - Dhjetor 2018

		Ky proces pritet të filloi në mars të vitit 2018			
	(iii)	Kryerja e të gjitha punimeve teknike për funksionalizimin e zonave të reja të presionit.	Zonat e reja të presionit janë funksionalizuar.	<ul style="list-style-type: none"> • Kryeshefi Ekzekutiv • Departamenti Teknik • Departamenti i GIS 	Janar 2019 - Dhjetor 2021

Shtojca 1: Aktivitetet për Reduktimin e Humbjeve Aparente - Kalendari dhe Buxheti (ne Excel)

Shtojca 2: Aktivitetet për Reduktimin e Humbjeve Reale - Kalendari dhe Buxheti (ne Excel)

Kompania Rajonale e Ujësllësit
Regional Water Supply Company

RADONIQI

sh.a. - j.s.c.

Rruga "UÇK" 7 Gjakovë
Tel:+381 390 320 503
Fax:+381 390 320 997



PROTOKOLI

Gjakovë
Rahovec
Lumbardh

28.12.2017
Nr:
273

Bazuar në Ligjin nr. 03/I-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji nr. 04/I-111 Bordi Drejtorëve në mbledhjen nr 26 të mbajtur me date 27.12.2017 pas shqyrtimit dhe diskutimit të Strategjise për zvogëlimin e humbjeve të ujit 2018-2020 për KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakove muarr;

V E N D I M

Aprovohet unanimisht Strategjia për zvogëlimin e humbjeve të ujit 2018-2020 për KRU"Radoniqi"sh.a-Gjakove.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi Drejtorëve dhe nënshkrimin nga Kryesues BtD.

Kryesues BtD


Fatos Koshi

